




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË –KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË ,KOSOVO POLJE



Datë: 13.03.2020

Kryetari i Komunës, pas shqyrtimit të shkresës së datës 12.03.2020 lidhur me zbatimin e Planit për gatishmërinë dhe reagimin e institucioneve për Coronavirus-in COVID - 19 sipas kërkesës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, bazuar në nenin 13, nenin 17, shkronja (s), nenin 58, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr.03/L-040 (GZ Nr.28/2008), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (n), nenit 44, të Statutit të Komunës, Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

1. Formohet Grupi Punues Komunal për reagimin dhe zbatimin e masave për mbrojtjen nga Coronavirus-in COVID-19 në përbërje si vijon:
 - 1.1 Jakup Dumani - Drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale - Kryesues i grupit;
 - 1.2 Osman Maxhera - Drejtor i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi'- Zëvendës Kryesues;
 - 1.3 Mustaf Gashi - Kryeshef i Mjekësisë Familjare në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' - anëtar;
 - 1.4 Remzi Shala - Shef i Mjekësisë Familjare në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi'- anëtar;
 - 1.5 Ejup Qyqalla - Shef për Shërbime Publike - anëtar;
 - 1.6 Adnan Bullatovci - Zyrtar i Lartë për Mjedis - anëtar;
 - 1.7 Halil Berisha - Shef i Logjistikës - anëtar;
 - 1.8 Ali Topalli - Zyrtar për Informim - anëtar;
 - 1.9 Qerim Gara - Nënkyetar i Komunës për Komunitete - anëtar;
 - 1.10 Sladjana Lazic - Shefe Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim - anëtare;
 - 1.11 Zoran Kitic- Zyrtar për të Drejtat e Komuniteteve dhe Integrim - anëtar.
2. Detyrë dhe përgjegjësi e Grupit Punues Komunal është zbatimi i Planit për gatishmëri dhe reagim për Coronavirusin-in COVID - 19.
3. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e nënshkrimit, nga Kryetari i Komunës.

Akti i dorëzohet:

- 1x Kryetarit të Komunës
- 1x Drejtorisë së SHMS
- 1x Anëtarëve të Grupit Punues
- 1x Arkivit

